



# KOMUNA – MITROVICË

Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komuna e Mitrovicës  
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



## KONTRATË – FURNIZIM, MONTIM dhe INSTALIM

### TITULLI I KONTRATËS

Përshkrimi i Kontratës : **Digjiitalizimi i Sistemit të pritjes në radhë për Qytetarët - D.Administrës.**

|                                |                          |
|--------------------------------|--------------------------|
| Numri i Prokurimit             | <b>642-22-3833-1-2-1</b> |
| Numri i Brendshëm i Prokurimit | <b>642/22/033/121</b>    |

AUTORITETI KONTRAKTUES: **KOMUNA E MITROVICËS JUGORE**

OPERATORI EKONOMIK: **PBC SH.P.K., Rr.Idriz Gjilani p.n., 10000, Prishtina, Kosovë**

DATA E NËNSHKRIMIT: **22/06/2022**

# PJESA B: KONTRATË –FURNIZIM,MONTIM dhe INSTALIM

**KOMUNA- MITROVICË JUGORE**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;  
dhe

**PBC SH.P.K., Rr.Idriz Gjilani p.n., 10000, Prishtina, Kosovë**

ne vazhdim "Kontraktori"), me nr Biznesi **810845985** nr i tel: **+383 (044) 467 467** ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike si vijon **Digjiitalizimi i Sistemit të pritjes në radhë për Qytetarët -D.Administrës.**

si në vijim:

## Neni 1 Lënda: **Digjiitalizimi i Sistemit të pritjes në radhë për Qytetarët - D.Administrës.**

me numër identifikues.

|                                |                          |
|--------------------------------|--------------------------|
| Numri i Prokurimit             | <b>642-22-3833-1-2-1</b> |
| Numri i Brendshëm i Prokurimit | <b>642/22/033/121</b>    |

1.1 Lënda e kontratës do të jetë [FURNIZIM,MONTIM dhe INSTALIM], nga kontraktori i furnizimeve si në vijim:

Lënda e kontratës do të jetë **Digjiitalizimi i Sistemit të pritjes në radhë për Qytetarët -D.Administrës.**

Operatori fitues i kontrates është i obliguar te furnizoj paisjet [ EKIOSQET ] sipas specifikave në DT dhe Përshkrimin e qmimeve te cilat i ka kërkuar njësia kerkuese [Drejtoria e Administrates e Komunës së Mitrovicës JUGORE].

|   |                   |
|---|-------------------|
| <b>Digjiitalizimi i Sistemit të pritjes në radhë për Qytetarët - D.Administrës.</b> | <b>9.996,00 €</b> |
|---|-------------------|

1.2 Kontrata hynë në fuqi **22/06/2022 dhe përfundon me 21/08/2022**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [kryerjes se FURNIZIMIT] është **Njësitë Kërkuese në Komunën e Mitrovicës JUGORE [ Vendi i vendosjes Zyra e OFIQRISË] objekti I KOMUNËS.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

## Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë:

Çmimi Total i ofertes **me TVSH** dhe vlerën e parashikuar **9.996,00 €**. **[Nëntë mijë e nënqindë e nëndhjetë e gjashtë euro e 00/100 € ]**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

## Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas të furnizimeve të kryera ose shumën totale të pagesës pas [ furnizimit, montimit dhe Instalimit ] dhe pas pranimit [njësitë e kërkeses] dhe raportit të nënshkruar nga Menaxheri I Kontratës.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitorët llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

## Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti *[Furnizimeve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

## Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 36 muaj ose 3 vite në bazë të deklaratës së Kontaktorit në ofertën e prezentuar

## Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

## Neni 14 Komunikimi

## Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht]<sup>2</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

| Për Autoritetin Kontraktues: <b>Komuna-Mitrovicë e JUGUT</b> |   |
|--|---|
| Emri:  | <b>Haxhimet FERATI</b>  |
| Pozita:  | <b>Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit</b>   |
| Nënshkrimi:  |  |
| Data:  | <b>22/06/2022</b>   |
| Vula:  |   |

| Për Kontraktorin: <b>PBC SH.P.K., Rr.Idriz Gjilani p.n., 10000, Prishtina, Kosovë</b> |   |
|---|---|
| Emri:   | <b>Bashkim SELMANI</b>  |
| Pozita:   | <b>Drejtor</b>  |
| NUI   | <b>810845985</b>  |
| Emajl adresa  | <b>Bashkim@pbc</b>  |
| Nr i tel  | <b>+383 (044) 467 467</b>   |
| Nënshkrimi:   |  |
| Data:   | <b>22/06/2022</b>   |
| Vula:   |  |

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

## **KUSHTET E VEÇANTA**

**NUMRI I TENDERIT : 642-22-3968-1-2-1**

KVK NË VIJIM DO TË PLOTËSOJNË DHE/OSE NDRYSHOJNË KPK. SA HERË QË KA  
NJË KONFLIKT, DISPOZITAT KËTU DO TË MBIZOTËROJNË MBI ATO TË KPK.

| KPK   |      | Amandamentimet / Modifikimi i Nenit përkatës në KPK  |
|---|------|--|
| Përshkrimi i nenit                                | Neni |  |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha                      | 1.1  | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                     |
|   | 1.2  | Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE.  |
| Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve               | 1.3  | Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është: <b>22/06/2022</b>   |
|   | 1.4  | Data e Përfundimit është: <b>21/08/2022</b>  |
|   | 1.5  | Vendi i kryerjes së furnizimeve është <i>Komuna e Mitrovicës JUGORE</i><br><b>Njësitë kërkuese te Komunës se Mitrovicës zyra e OFIQARISË në Objektivin e Komunës.</b>  |
| Emrimi i Menaxherit te Kontratës                  | 1.6  | Menaxheri i Kontratës është: [.....@rks-gov.net].  |
| Dëmet e likuiduara                                | 1.7  | Dëmet e likuiduara për të gjitha furnizimet janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.<br>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10%</b> e Çmimit final të Kontratës |
| Siguria e ekzekutimit                             | 1.8  | Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: <b>N/A</b>  |
| Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve | 1.9  | Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë:<br>a) Përgjegjësia e Palës së Tretë [N/A]<br>b) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve   |

**KONTRATË: Digjitalizimi i Sistemit të pritjes në radhë për Qytetarët -D.Administrës. Nr i prokur: 642-22-3833-1-2-1 dhe Nr i brend: 642/22/033/121**

|  |      |   |
|--|------|---|
|  |      | <p>[me marrëveshje te dy palëve]</p> <p>c) Përgjegjësia profesionale [N/A]</p> <p>d) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës [N/A]</p>  |
| Parimet e përgjithshme të pagesës                    | 1.10 | <p>Orari i pagesës do të jetë: Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas situacioneve të furnizimeve të kryera pas [ furnizimit, montimit dhe Instalimit ] dhe pas pranimit [njësitë e kërkeses] dhe pas pranimit nga njësitë e kërkeses verifikimi i performancës së Paisjeve dhe raportit të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës</p>   |
| Kontrolli i kualitetit dhe Obligimet e Kontraktorit. | 1.11 | <p>Kontraktuesi duhet të furnizoj PAISJET të cilat duhet të montohen testohen dhe të lëshohen në Funkcion dhe të mirëmbahen dhe të trajnohen Zyrtarë për përdorim.:</p> <p><b>Garancioni i PAISJEVE dhe komponentëve përbërëse duhet të jete 12 muaj. Brenda periudhës garantuese, duhet të ofrohen trajnimet për stafin komunal për përdorim të eKioskes dhe mbushjen me dokumente (për se paku 3 veta).</b></p> <p><b>Operatortri Ekonomik është i obliguar ti Furnizoj, Montoj, Instaloj dhe ti vendos në funksion Paisjet për Menaxhim të radhës dhe të trajnoj STAFIN për përdorim dhe të mirëmbaj për 12 muaj.</b></p>  |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes                  | 1.12 | <p>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</p>   |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore    | 1.13 | <p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p> |

## PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

| MBAJTËSI I LLOGARISË |  |
|----------------------|--|
| Emri                 |  |
| Adresa               |  |
| Qyteti               |  |
| Kodi Postar          |  |
| Kontakti             |  |
| Telefoni             |  |
| Fax                  |  |
| E-mail               |  |
| Numri i TVSH         |  |

| BANKA            |  |
|------------------|--|
| Emri             |  |
| Adresa           |  |
| Qyteti           |  |
| Kodi Postar      |  |
| Shteti           |  |
| Llogaria Bankare |  |
| IBAN (opcionale) |  |
| BIC (Opcionale)  |  |

### SHËNIME:

|   |
|---|
| <u>VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme).</u> |
|---|

|   |
|---|
| <u>DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme).</u> |
|---|



**SPECIFIKIMI I QMIMEVE**

**NENI II-PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE- Titulli: Digitalizimi Sistemit të pritjes në radhe për Qytetarët -D.Administrates**  
**Nr i prok: 642-22-3833-1-2-1 ; Nr I brendsh: 642/22/033/121**

| Nr.  | Lloji i artikullit<br><b>në radhë për Qytetarët -D.Administrates</b>   | Njësia matse | Sasia | Qmimi njësi pa TVSH | TVSH | Qmimi njësi me TVSH | TOTALI Gjithsejt |
|--|--|--------------|-------|---------------------|------|---------------------|------------------|
| 1.   | Krijimi dhe Mirembajtja e Sistemit për Pritje ne Radhë, (mirëmbajtja për 12 muaj)  | copë         | 2     | 1,271.19            | 18%  | 1,500.00            | 3,000.00         |
| 2.   | Pajisja për lëshimin e tiketave  | copë         | 2     | 2,542.37            | 18%  | 3,000.00            | 6,000.00         |
| 3.   | Smart TV minimum 49"   | copë         | 2     | 381.36              | 18%  | 450.00              | 900.00           |
| 4.   | Pjesët dhe materialet tjera për funksionalizim te sistemit ne tërësi (Këtu përfshihen pjesët tjera përcjellëse sipas nevojës si konverteret, adaptaret me rryme, kanalet plastike, prizat dhe kabllo për rryme dhe rrjete, dhe materiale tjera te pa specifikuara) | paushall     | 1     | 40.68               | 18%  | 48.00               | 96.00            |
| <b>GJITHSEJT Totali i Përgjithshëm me TVSH :</b> |  |              |       |                     |      |                     | 9,996.00         |

Vërejtje:Përmbaju ANEXI I-Specifikimet Teknike te Detyrueshme në DT.

1. Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) shifra pas presës dhjetore. Çdo shifër e shënuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës., oferta e tillë do të konsiderohet e pa përgjegjshme.
- 2.Në çmim të përfshihen të gjitha taksat e aplikuara në Kosovë,duke llogaritur edhe tvsh-në
- 3.Operatorët Ekonomik me Çmime Jo-normalisht të ulët do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.
- 4.Nëse ndodhë ndonjë gabim në plotësimin e paramases AK nuk mbanë përgjegjësi

**SPECIFIKIMI I QMIMEVE**

**NENI II.PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE- Titulli: Digjitalizimi Sistemit të priftjes në radhë për Qytetarët -D.Administrates**

**Nr i prok: 642-22-3833-1-2-1 ; Nr i brendsh: 642/22/033/121**

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)  |   |
|--|---|
| EMRI I OE:                               | PBC sh.p.k.   |
| EMRI DHE MBIEMRI I PERFAQESUESIT TE O.E. | Bashkim Selmani   |
| NENSHKRIMI:                              |               |
| DATA DHE VULA:                           | 10/05/2022<br> |